

VENDIM
Nr. 52, datë 27.1.2021

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
HARTIMIT TË PROJEKTIT TË NDËRHRYJEVE
REHABILITUESE/PËRSHTATËSE TË NEVOJSHME PËR KTHIMIN E
STRUKTURËS SË OBJEKTEVE QË JANË KLASIFIKUAR SI OBJEKTE ME
DËMTIME TË MËDHA STRUKTURE OSE DËMTIME SHUMË TË RËNDA
JOSTRUKTURE, NË BASHKINË KRUIJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 64 047 500 (gjashtëdhjetë e katër milionë e dyzet e shtatë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH, për financimin e hartimit të projektit të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse të nevojshme për kthimin e strukturës së objekteve që janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore, në Bashkinë Krujë.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e shtetit për vitin 2021, dhe i transferohet, në formën e transfertës së pakushtëzuar, Bashkisë Krujë.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama